



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_/2017

**PËR DISA NDRYSHIME  
NË LIGJIN NR. 171/2014 “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË  
KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE  
NË PRONËSI TË PËRFITUESVE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2, pika 2, në shkronjën “b” paragrafi “v” shfuqizohet.

**Neni 2**

Në nenin 5, pika 2 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Nëse nga informacioni zyrtar i siguruar gjatë verifikimit të gjendjes juridike të pronës, rezulton se toka bujqësore është objekt shqyrtimi në gjykatë dhe ky institucion: ”

2. Në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b”, fjala “përcaktojnë”, zëvendësohet me fjalën “përcakton”.

3. Në pikën 2, në shkronjën “c”, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:  
“c. nuk arrin të marrë vendim të formës së prerë, brenda afatit të plotësimit të AMTP-ve, sipas përcaktimit të nenit 6 të këtij ligji, atëherë vazhdon përdorimi i tokës nga përdoruesi, deri sa të ketë një vendim të formës së prerë nga gjykata”.

#### Neni 3

Në nenin 6, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish -ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 31 korrik 2018.”

#### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**